



Akademia e Drejtësisë, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6 A paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor dhe Vendimit Nr. 01/495/2023 i datës 19.10.2023 të Këshillit Drejtues, publikon këtë:

## **Shpallje Publike**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Akademia e Drejtësisë synon krijimin e një qasjeje të barabartë për të gjithë të interesuarit për aplikim.

### **I. Titulli i pozitës së punës:**

Anëtar i Këshillit Programor – një pozitë

### **II. E drejta për propozim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor:**

- Kryetarët e Gjykatave;
- Kryeprokurorët;
- Drejtuesit e institucioneve tjera.

### **III. Të drejtë aplikimi kanë personalisht:**

- Gjyqtarët;
- Prokurorët dhe
- Profesionistët ligjorë.

### **IV. Kriteret e aplikimit:**

Kandidati për anëtar të Këshillit Programor duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

- Kompetencë të dëshmuar në një fushë të caktuar të së drejtës ose në sistem të drejtësisë;
- Pesë vjet përvojë profesionale në sistemin e drejtësisë;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e trajnimit gjyqësor.

### **V. Dokumentet e kërkuara për aplikim:**

- CV-në;
- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit që vërteton pozitën e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështeten me një nga dokumentet si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale ose

pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;

- Dëshmi për përvojë në fushën e trajnimit gjyqësor.

## **VI. Mandati i anëtarit të Këshillit Programor:**

Katër (4) vjet me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

## **VII. Pagesa e anëtarit të Këshillit Programor:**

Anëtari i Këshillit Programor kompensohen në lartësinë prej shtatëdhjetë (70%) të kompensimit të anëtarit të Këshillit Drejtues, në bazë të takimeve të mbajtura dhe pjesëmarrjes në to.

## **VIII. Mënyra e nominimit apo aplikimit:**

Nominimi apo aplikimi mund të bëhet në njërin nga mënyrat si vijon:

- Përmes postës;
- Përmes emailit: [arianit.shabani@rks-gov.net](mailto:arianit.shabani@rks-gov.net);
- Dorëzimit fizik në Akademi.

## **IX. Afati i fundit për nominim apo aplikim:**

Dokumentet e aplikimit sipas pikës IV të kësaj shpalljeje publike duhet të dorëzohen deri më datë 26.12.2024.

Qëllimi kryesor i këtij procesi është plotësimi i përbërjes së plotë të Këshillit Programor me anëtarë në përputhje me nenin 15, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, i cili përcakton: “Këshilli Programor përbehet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues nga radhët e Gjyqtarëve, Prokurorëve të Shtetit dhe ekspertëve tjerë”.

Për çdo informatë shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 18 582 / +383 (44) 89 00 89 ose në email adresën: [arianit.shabani@rks-gov.net](mailto:arianit.shabani@rks-gov.net)

**Shënim:** Për informata më të detajuara rreth Këshillit Programor mund të konsultoni Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Rregulloren Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor, si dhe Rregulloren Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.

Klikoni mbi vegzat më poshtë për t'u lidhur në mënyrë elektronike me aktet ligjore.

[Ligji për Akademinë e Drejtësisë](#)

[Rregullore Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor](#)

[Rregullore Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë](#)